



Asambleja
01.Nr.II
Deçan,dt.31.03.2021

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e II-të të rregullt të Asamblesë Komunale , me dt.31.03.2021.

Në mbledhje ishin prezent:24 anëtarë të asamblesë, Kryetari i Komunës, disa drejtor të drejtorive komunale, Kryesuesi i Komitetit të Komuniteteve, OJQ, mediat.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, zotëri Haki Shehaj.

Për mbledhje ishte propozuar ky rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Zëvendësimi i anëtarit të Kuvendit Uran Tolaj me kandidatin e radhës Ismet Çekaj nga subjekti i njëjtë politik Lidhja Demokratike e Kosovës - LDK dhe dhënia e betimit solemn,
3. Shqyrtimi i raportit të Ndërmarrjes “Higjiena”,
4. Marrja e vendimit për përkrahje financiare për qytetarët e Komunës së Deçanit të prekur nga Covid 19 dhe familjarët e viktimave të Covid 19,
5. Marrja e vendimit për orientimin e të hyrave të bartura të vitit 2020 në vitin 2021,
6. Shqyrtimi i Raportit financiarë për vitin 2020,
7. Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi mbledhjen e II-të të rregullt të Kuvendit duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje janë prezent 24 asamblist (mungojnë Albana Avdiu, Besjana Ukëhaxhaj dhe Milazim Mushkolaj).

Kryesuesi- e prezantoi rendin e punës të propozuar me ftesë, në vazhdim ka njoftuar se është rekomandim i KPF-së që pika nr.3- Shqyrtimi i raportit të Ndërmarrjes “Higjiena”, të hiqet nga rendi i ditës për arsye të mos informimit me kohë të menagmentit të ndërmarrjes për përgaditjen me shkrim të raportit dhe si rrjedhojë rekomandohet që raporti të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Illir Ferizaj- thot se e kam mirëprite njoftimin se do ta kemi ne rend dite kete raport, sepse unë i kam disa shqetësime lidhur me ndërmarrjen Higjiena, si pikë e parë nuk e ka funksional komisionin e aksionarëve poashtu nuk kanë edhe një varg organesh tjera që nevojiten për funksionim normal të ndërmarrjes. Ne kemi marrë informacione këtu në Kuvend se Ndërmarrja ka trashëgu borgje, Komuna ka investu shumë në këtë ndërmarrje siq është blerja e makinerisë dhe një varg investime tjera, rreth 90.000 € DSHP-ja i ka borgje ndaj kompanisë Higjiena, nuk e kanë zhvillu aktivitetin e prokurimit publik, ndërmarrja e ka një Kryeshef që nuk di se kush e ka mëru ndërsa dihet sipas ligjit si është procedura e emrimit të Kryeshefit dhe punëtorëve tjerë aty.

Kryesuesi- njofton se në mbledhje të KPF-së ka marrë pjesë Kryeshefi i Ndërmarrjes Higjiena dhe si KPF kemi rekomanduar që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës në këtë mbledhje dhe të vjen mbledhjen e radhës prandaj nuk mendoj se duhet të zgjatim debatin sot rreth saj.

Mon Selmonaj- tha se në KPF ka ardhë Kryeshefi i Ndermarrjes Higjiena dhe ka thene se ka qene i pa njoftuar me kohë që e ka ne rend dite raportin dhe duhet ta pergadite per kete mbledhje, prandaj shtroj pyetjen ka thënë ai se çka është ky mos harmonizim i detyrave të punës Kuvend-Ekzekutiv. Në KPF jam pajtuar që të hiqet si pikë nga rendi i ditës dhe qëndroj prap pro asaj që kjo pikë të hiqet sot, mirëpo ne mbledhjen e kaluar kemi kërkuar që të na vijnë edhe disa pika tjera siq janë raporti rreth Loteve që janë dhënë në shfrytëzim, por siç po shihet nuk kanë ardhë.

Kryetari i Komunës- thot se e shoh të arsyeshme që të përgjigjem në pyetjet e shtruara rreth ndërmarrjes , fillimi i themelimit te kësaj ndërmarrje është viti 2016, e cila është trashëguese e

trashëgu nga ndërmarrja e kaluar, i kemi borgjet te ATK, e kemi një Bord të Ndërmarrjes dhe sipas ligjit duhet te raporton ne kuvend, është gabim që nuk është njoftu me kohë udhëheqësia e ndërmarrjes, por besoj qe mbledhjen tjetër do ta kemi raportin këtu.

Illir Ferizaj- duhet me shku sipas hapave dhe procedurave ne menyre qe mi pas nje pasqyre te mire te ndërmarrjes, qe dy vjet e kërkojmë por nuk kemi pasë raport, unë i kam disa informacione nga drejtori mirëpo besoj qe do te vjen raporti dhe sqarohet çdo gjë.

Kryesuesi-në vazhdim i prezenton pikat qe vijnë per shqyrtim me rekomandim të KPF-së, dhe veç e veç i qet edhe ne votim si pika qe duhet te shyrtohen dhe miratohen.

1.Rekomandimi i Komisionit per emrim të rrugëve:1.Rruga “Adem H. Zukaj” ne fshatin Beleg, dhe 2.Rruga “Rexhë Pajazitaj” ne fshatin Isnig, miratohet njëzëri dhe hyn në rend dite.

2.Kërkesa e KF’DEÇANI”per përkrahje financiare ne vlere 7000 €, për arsye që shuma e mjeteve të kërkuara duhet të miratohet në Kuvend, prandaj përveq KPF-së kërkesa duhet të debatohet prap dhe të merret vendimi në Kuvend, miratohet njëzëri dhe hyn në rend dite.

1.Shpallja e pronave me interes për nevojat e zgjerimit te rrugës në Qendër të qytetit, pjesë nga parcela nr.00933 shpallet me interes siperfaqja prej 212 m² dhe nga parcela nr.00931-2 shpallet me interes siperfaqja prej 16 m², bazuar në elaboratin gjeodezik, miratohet njëzëri dhe hyn ne rend dite.

2.Rishpallja e pronave me interes, per nevojat e rregullimit te shtratit te lumit –Lumbardh i Deçanit, vendim i kuvendit i dt.30.11.2020, i cili kërkon edhe nje here votim ne kuvend dhe marrje te vendimit, për arsye që tri prona atëherë ishin në hipotekë ndërsa tani janë larguar nga hipoteka.

1. Plani Lokal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për periudhën 2021-2025

2. Plani për Deponinë e Mbeturinave Inerte për Komunën e Deçanit.

3. Plani për Qendrën e Grumbullimit dhe Magazinimit të Mbeturinave të Vëllimshme.

Me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit dhe kërkesën e MAPL, kërkohet që këto tri akte të harmonizohen me dispozitat ligjore në fuqi, prandaj si të tilla edhe një herë duhet ti nënshtrohen procesit të votimit në Kuvend.

Kryesuesi i ka qitë në votim katër pikat që kërkohet të marrin edhe një herë miratimin në Kuvend, antarët e kuvendit njëzëri i miratojnë dhe hyjnë në rend dite.

Në fund kryesuesi e qiti në votim rendin e punës të propozuar me ftesë pa pikën nr.3 bashkë me pikat e rekomanduara nga KPF.

Rendi i punës pa pikën nr.III. Shqyrtimi i raportit të Ndërmarrjes “Higjiëna” dhe me pikat e rekomanduara nga KPF miratohet njëzëri.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

-Miratohet njëzëri pa vërejtje.

II. Zëvendësimi i anëtarit të Kuvendit Uran Tolaj me kandidatin e radhës Ismet Çekaj nga subjekti i njëjtë politik Lidhja Demokratike e Kosovës - LDK dhe dhënia e betimit solemn.

Ismet Çekaj nga subjekti politik Lidhja e Demokratike e Kosovës(LDK) ka zëvendësuar bashkëpartiakun e tij, Uran Tolaj, të cilit i është ndërpre mandati sipas kritereve të nenit 37 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 10 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, për shkak të mungesave pa arsye në mbledhjet e Kuvendit. Ismet Çekaj ka dhënë betimin solemn dhe nga ky moment është anëtar i Kuvendit të Komunës së Deçanit me të drejta të plota.

III. Shqyrtimi i raportit të Ndërmarrjes “Higjiëna”.

Me rekomandim të KPF-së kjo pikë hiqet nga rendi i ditës.

IV.Marrja e vendimit për përkrahje financiare për qytetarët e Komunës së Deçanit të prekur nga Covid 19 dhe familjarët e viktimave të Covid 19.

Kryesuesi- e ka prezentu pikën pastaj ka sqaruar se edhe KPF ka rekomanduar qe te perkrahen kjo kategori i qytetarëve.

Drejtori i buxhetit, Agron Demukaj- sqaron se ne si komunë e kemi listën zyrtare te te prekurve nga Covid 19 qe eshte lista e IKSHP-së, mirëpo qytetarët kanë bërë teste edhe në laboratorët privat por ne nuk jemi të paisur me këto të dhëna, por nuk jemi të interesuar që të bëjmë dallimet te qytetarët, vendimin se kush duhet te përfiton e kush jo, do ta merrni ju, mirëpo ne kemi menduar qe per mos

me ba dallime te qytetarët tonë te hapim aplikacionin Online me afat 30 ditore ku do te aplikojnë te gjithë qytetarët e Komunës së Deçanit qe kanë rezultuar pozitiv me Covid 19, per shumen dhe per kriteret prap ju do te vendosni, mirëpo per momentin nuk kemi mjete te mjaftueshme buxhetore per përkrahje deri me Rishikim te buxhetit sepse duhet mi hjeke ni projekt se nuk kemi buxhet,ndërsa per rastet e vdekjes nga Covid 19 , familjaret e viktimave duhet te plotësojnë dokumentacionin qe deshmon se ka vdeke nga Covid 19 dhe do te përfitojnë menjëherë pasi qe ky vendim te behet i plotfuqishëm pa e pritë Rishikimin e buxhetit, përkrahja do te behet sipas vendimit qe e kemi per shpenzime te varrimit-nga 200 euro per çdo rast.

Albesa Cacaj- ne KPF kemi thene qe ju sot me ardhe me propozime konkrete.

Drejtori i buxhetit thot se ne ju kemi shkru laboratorve privat dhe ata na janë përgjigje se nuk ju raportojmë juve dhe nuk na i kan dhene listën e personave qe kane dale pozitiv , nëse ju si asamblist kuni ndonjë ide e debatojmë bashkë këtu dhe vendosim.

Albesa Cacaj- pyet per 100.000 € qe i kemi nda per pandemi, ku kan shku ato mjete dhe a ka ndonje raport per to.

Drejtori i buxhetit-pergjigjet se 30.000 € nga ato i kuni me te hyra te bartura.

Illir Ferizaj-thot se po pajtohna me propozimin qe te krijohet aplikacioni online, por jo me afat te caktuar sepse vazhdimisht po infektohen njerëzit.

Agnesa Vokshi- jam e pajtimit me parafolësin qe aplikacioni mos te jete me afat te caktuar sepse infektimi i njerëzve po ndodhe çdo dite, pastaj ajo ka shtruar pyetjen se a do te perkrahen te gjithë njësoj me mjete financiare apo a ka ndonjë dallim mes atyre qe jan hospitalizu dhe kan shpenzu shum dhe disa qe vetëm kan rezultu pozitiv por nuk kan pase shpenzime.

Drejtori i buxhetit- thot ju do ti caktoni krejt kriteret, ne vetëm e zbatojmë.

Florim Mataj-thot se mund ti ndajmë ne dy periudha, me vite, te prekurit ne vitin 2020 dhe ne vitin 2021, mirëpo i kisha nda edhe rastet sociale me ju nda ma shum, nga ata qe janë ne gjendje ma te mire financiare qe mendoj me shku me shuma minimale .

Illir Ferizaj-thot se unë pajtohem qe ta hjekim ni projekt sepse kane nevojë njerzitet dhe te fundi ato mjete te qytetari jone po shkojnë por jo me shku me shuma minimale per askend.

Florim Mataj- thot se propozova qe te perkrahen dy kategori sepse nuk i përballojmë me vlera te mëdha sepse nuk kemi buxhet te mjaftueshëm, përndryshe nëse kemi mundësi do ti përkrahim edhe ne vlera te mëdha.

Drejtori i buxhetit- propozon qe te krijohet aplikacioni online pa afat dhe aty te futet gjendja ekonomike, pastaj ne qershor e sigurojmë listën e personave te prekur si dhe do te përcaktohet edhe shuma e mjeteve per çdo person te prekur nga Covid 19.

Mon Selmonaj- tha se drejtori i la disa dilema, sepse kur e kam ba kërkesën ne dhjetor per ti përkrah personat e prekur me covid, drejtori i Inspektionit ka pas thene se e kemi listën e personave qe kane rezultuar pozitiv, poashtu mendoj se nuk duhet te behet përjashtim te qytetarët.

Kryesuesi- propozon qe te hapet aplikacioni te aplikojnë qytetarët e prekur me covid pastaj e shofim ne qershor sa na ka shku numri i qytetarëve të prekur dhe i shofim edhe mundësitë tona financiare dhe përcaktohem sa do te jete shuma qe do perkrahet çdo qytetar i infektuar me covid, ndërsa per rastet e vdekjes nga 200 € per çdo rast dhe te ekzekutohen menjëherë pasi te hyn ne fuqi vendimi.

Albesa Cacaj- tha se drejtori i buxhetit na ka thene ne KPF se i kemi 1 mil. E gjysme rezerva buxhetore.

Erdogan Dautaj-fillimisht i uron mirëseardhje ne Kuvend Ismet Çekaj, e pastaj tha se i patëm dy propozime , qe te ndahen ne dy periudha te prekurit dhe te ndahen ne raste sociale dhe qytetarët tjerë që nuk janë rast social, ndërsa unë propozoj qe te gjithë qytetarët te trajtohen njejte pa dallim.

Drejtroi Inspektionit, Halil Tolaj- tha se per ne si Institucion valide janë listat e te infektuarve qe kane ardhe nga Instituti dhe deri dje me dt.30 janar 2021, 967 persona kanë qenë të infektuar me covid 19 nga Komuna e Deçanit, ndërsa shënime nga burime tjera nuk kemi.

Erdogan Dautaj-thot se nuk ban mi nda personat qe kane rezultuar pozitiv me covid 19 me teste nga Laboratori privat me ata qe kane dale nga Instituti por te gjith njejte, sepse njerzitet e kan ba testin

privat dhe kane shpenzu edhe ma shum dhe te përjashtohen nuk ban, prandaj propozoj qe te perkrahen njejte kush ka dale pozitiv pa marre parasysh ku e ka ba testin.

Kryesuesi- thot se Instituti i ka licencu edhe Laboratorët privat prandaj duhet të pranohen të dhënat e tyre.

Mahmet Osaj- thot se qëllimi jonë është qe ti ndihmojmë qytetarët, prandaj këtu nuk duhet te kete dallim se ku ka dale pozitiv, te Instituti apo te laboratorit privat, mirëpo meqenëse ka qene vit i veshtire dhe qytetarët kane pase humbje ekonomike propozoj qe me jau hjeke tatimin ne prone .

Drejtori buxhetit- sqaron se tatimi ne prone është kompetence e delegume ne komune dhe ne vetëm e administrojmë ate, prandaj edhe nuk mund te ndërhyjmë aty.

Albesa Cacaj- thot se është dashtë me ardhe me propozim konkret sot.

Drejtori i buxhetit- thot se do te hapet aplikacioni ku çdo njeri ka mundësi te aplikon prej shpie, e pastaj do te vazhdojmë me radhe me procedure.

Kushtrim Loshaj- kërkon qe te respektohet rregullorja e punës dhe te flasim me radhe dhe mos ta merr fjalën nje delegat disa here duke i perserite fjalët ne te njëjtën pike.

Valdet Nuraj-pyet se a ka mundësi me ardhe pala ne komune me apliku se disa nuk kane njohuri te mjaftueshme ne teknologji dhe nuk mund te alikojne prej shpie.

Drejtori i Buxhetit- pergjigjet, po, edhe per kete do te kujdesemi dhe do ta caktojmë nje pike kontaktuese ku do te mund te drejtohen qytetarët qe nuk aplikojnë prej shpie.

Kryesuesi- thot se per rastet e vdekjes menjëherë pasi te hyn ne fuqi vendimi do te fillon edhe zbatimi e tij nga 200 € per te cilin me kerkese dhe dokumente te kompletume do te aplikon familjari i viktimës , ndërsa per te infektuarit hapet aplikacioni dhe ne qershor me rishikim caktohet edhe shuma e mjeteve qe do te perkrahet çdo njeri edhe do te shuhet nje projekt sepse nuk kemi buxhet per pagimin e kësaj kategorie, kete propozim e qiti ne votim, antaret e kuvendit e miratojnë njëzëri ne momentin e votimit 21 asamblist ishin prezent në sallë.

V. Marrja e vendimit për orientimin e të hyrave të bartura të vitit 2020 në vitin 2021.

Kryesuesi e prezentoj piken pastaj per sqarime e ftoj drejtorin e buxhetit, i cili e ka sqaruar propozimin e ekzekutivit per orintimin e te hyrave te vitit 2020 qe barten ne vitin 2021.

Albesa Cacaj- thot se edhe ne KPF kam kërkuar qe te merren parasysh mirëmbajtja e lapidarëve te dëshmorëve sepse disa jan ne gjedje te keqe si psh. Lapidari i Sali Çekaj ne qendër te qytetit, kerkoj qe te hyn si propozim i imi poashtu propozoj qe mirëmbajtjen ta bene ndërmarrja Higjiena.

Drejtori Buxhetit- thot se ne me Ndermarrjen Higjiena e kemi nje Kontrate ne Shpi dhe ju sot mund ta merrni ni vendim qe asaj kontrate me ja shtu edhe mirëmbajtjen e lapidarëve.

Florim Mataj-thot se ne sot nuk e kemi kontratën ne shpi me dite se çka ka ne te se ndoshta e ka ne kontrate edhe mirambajtjen e lapidarëve.

Kestrim Avdimetaj- thot se e kam pas ba nje kerkese per rregullim te nje rruge ne fshatin Strelle me gjatësi 100 m dhe ne kete kuvend është aprovuar unanimisht , mirëpo ajo nuk është kry kurr, prandaj kerkoj sqarim pse nuk është kry sepse deri te ajo rruge jan kry punimet dhe ajo është nda dhe është lene pa u kry, si dhe a ka mundësi mu kry bile tash.

Fekri Qufaj- ankohet se nuk janë kry mire punët kur është bere rregullimi i rrugëve ne fshatin Prejlep, sepse ne Prejlep asgja nuk kuni punu si Komunë ka thënë ai, kurse disa rruge me te njohur edhe ne livadhe jan kry.

Ilir Ferizaj- vërejtje , te ndriqimi publik ne fshatra, per arsye se ne Strelle është punu shum keq , është kry ni pjese kurse e kan lanë nje pjese ku dendësia e popullsisë është ma e madhe, a ka mbikëqyrës te projektit ktu, a jo.

Valdet Nuraj- thot, sakt, bash qysh po thot Iliri osht, ni pjese e kan kry, kurse pjese tjetër ku është popullsia ma e dendur e fshatit ka mbete ne terr dhe per kete nuk na kan pyet ne fare..

Shkelqesa Hadergjonaj-ka ngrite qeshtjen ndriqimit te fshatit Sllup i cili është ndërpre ne Dranoc, kërkon arsye pse ka ndodhe kjo.

Drejtori i buxhetit- thot se u informova se sot kryhet ndriqimi i fshatit Sllup, ndërsa per ndriqimin e fshatit Strelle do ta adresoj kërkesën e juaj ne adresën e duhur.

Kryesuesi- e qiti ne votim propozimin e Ekzekutivit per bartjen e te hyrave vetanake te vitit 2020 te bartura ne vitin fiskal 2021 , pa ndonjë ndryshim, antaret e kuvendit e miratojnë me shumic votash, rezultati i votimit ishte 20 per, 3 kunder, 1 abstenim. Antaret e kuvendit kane miratuar tbartje e te hyrave qe do te orientohen si me poshtë:

-Kategoria ekonomike _Paga dhe mëditje.....shuma totale prej 752.50 euro, janë THV nga fondi burimor (21), të arkëtuara në muajin dhjetor. Te ridestinohen ne paga shendetsialokimi ne :

Blloku kodues: 21/631/73900/111/00000/0721..... shuma 752.50 euro

-Kategoria ekonomike _Mallra dhe Sherbime.....shuma totale prej 30,052.59 euro, ku shuma prej 52.30 euro mjete të alokuara dhe te pa shpenzuara dhe shuma prej 30,000.00 euro janë THV nga fondi burimor (21), të arkëtuara në muajin dhjetor, ndërsa shuma 0.29 euro janë THV të bartura nga viti 2019. Te ridestinohen ne mallera dhe shërbime per nevoja te furnizimit per materiale hixhenike dhe dezinfektuese alokohen ne këte kod:

Blloku kodues: 21/631/17515/130/00000/0112..... shuma 30,052.59 euro

-Kategoria ekonomike _Subvencione dhe transfere.....shuma totale 25,113.26 euro, ku shuma prej 6,136.30 euro, janë THV të arkëtuara në muajin nëntor dhe te alokuara në muajin dhjetor pas mbylljes së vitit fiskal, ndërsa shuma prej 18,820.70 euro, janë THV nga fondi burimor (21), të arkëtuara në muajin dhjetor, ndërsa shuma 156.26 euro janë THV të bartura nga viti 2019.

Blloku kodues: 21/631/16015/200/00000/0111..... shuma 25,113.26 euro

- Shuma prej 8,000.00€ CHWB obligimi ndaj memorandumit
- Shuma prej 3,000.00€ Swiss Contact obligimi ndaj memorandumit
- Shuma prej 11,000.00€ Drini i Bardhë obligimi 2020
- Shuma prej 2,000.00€ Shtepia e sigurtë Pejë
- Shuma prej 1,113.26 subvencione zyra e kryetarit

-Kategoria ekonomike _Investimeve kapitale.....shuma totale 56,247.23 euro, , janë THV nga fondi burimor (21), të arkëtuara në muajin dhjetor. Te alokohen ne kodet e projektit:

Blloku kodues: 21/631/18015/300/50718/ 0451 Rekonstruim i varrezave te deshmoreve - shuma 56,247.23 euro

Mjetet financiare per te mbuluar kontratat për projektin e Lapidarit te fshatit Belle dhe Lapidarin Carrabreg te Eperm.

VI. Shqyrtimi i Raportit financiarë për vitin 2020.

Kryesuesi- e prezentoj piken pastaj e hapi debatin..

Ilir Ferizaj-ka bere vërejtje te kodi dreka shuma prej 56.000 € gjate kohës se pandemisë , dreka zyrtare -40,156 € jan shum, kjo eshte nje vlere shum e madhe kur e dijme se restorantet kane qene te mbyllura dhe kur e kalkulojmë na del se 237 € 25 eurocent janë shpenzuar ne çdo dite gjate vitit 2020 dhe me thane te drejtën kam prite qe kete vit me pase ma pak shpenzime, mirëpo këtu figuron nje shpenzim te nje kompani qe nuk merret fare me pako ushqimore.

Florim Mataj- ne kete pike edhe une pajtohem, kete çështje e kam ngrite ma herët dhe kam qene kundër dhe ma kritik se ti, sepse me këto shpenzime kishim mujte me i ndihmu 100 persona te prekur me covid 19.

Albesa Cacaj-edhe nje here them se eshte keqmenagju buxheti, shumica e buxhetit eshte shpenzu per puntor me kontrate ne vepër, ka vërejtje edhe te shpenzimi i buxhetit per dreka zyrtare ne kohe pandemie kur komuna ka punu me staf te reduktuar, shpenzim i buxhetit per mirëmbajtje te veturave per te cilin kemi kërkuar sqarime edhe vitet e kaluara, , shpenzim i buxhetit me përmbarues privat-edhe kjo eshte nje rekomandim i auditorit te jashtëm qe komuna mos te hyn ne raporte kontraktuale

pa buxhet, dhe qe disa vite rresht kam kërkuar qe mjetet e taksapaguesve te perdoren per te mirën e tyre.

Kryesuesi- thot se kuvendi per tri vite rresht i kemi hargju 20.000 €.

Mon Selmonaj- qe tri vjet kemi bo vërejtje per te gjitha këto shpenzime marramendëse qe i permenden parafolësit e mi dhe nuk po i përsëris te njëjtat, kam pyetje per drejtorin kur ti analizojmë shpenzimet a kemi ngritje apo rënie te shpenzimeve duke krahasuar shpenzimet e vitit 2019 me ato te vitit 2020 per çdo kategori te shpenzimeve, prandaj unë kerkoj ulje te shpenzimeve, ne vazhdim ai ka thene se i kemi pas miratu 5000 € per garderobe te Ansamblit te valleve dhe nuk e hasa si shpenzim qe eshte ekzekutu ai vendim, prandaj kerkoj sqarim.

Valdet Nuraj-thot se per hire te korrektësisë ka nje sqarim te shpenzimi i subvencioneve ku ceket emri im, eshte dashtë te ceket dhe te sqarohet këtu se per çka janë marre ato mjete dhe ju njoftoj se këto mjete kanë shkuar per ngritjen e nje pllake perkujtimore ne Qafë të Bogiqes.

Drejtori buxhetit-sqaron se te shuma mbi 40.000 € , prej tyre 15,000 € kan shku per pandemi dhe per te gjitha janë faturat qe e tregojnë per qdo shpenzim, te kontratat ne vepër –te gjitha janë ndërpre me vendim te kryetarit, ndërsa raportin krahasues do te jau sjelli raportin tremujor krahasuar 2020-2021, te përmbaruesi jemi munduar qe te kryejmë pune ne te mire te qytetarëve e pastaj në mos mundësi te përmbushjes se obligimeve ata po na i marrin me përmbarues, te vërejtja e Valdetit, eshte e vertete qe ato mjete janë dale ne emër te Valdetit per pllake perkujtimore dhe ne kete rast i kerkon te falur Valdetit pse nuk eshte dhene sqarimi se per çka janë dhënë ato mjete dhe premtion se tjetër here do te sqarohen këto raste.

Kryesuesi- me shpresën se ekzekutivi do ti ule shpenzimet aty ku mundet e mbylle debatin rreth kësaj teme.

VII. Rekomandimi i Komisionit per emrim të rrugëve:1.Rruga “Adem H. Zukaj” ne fshatin Beleg, dhe 2.Rruga “Rexhë Pajazitaj” ne fshatin Isniq.

Kryesuesi-e prezenton piken dhe sqaron se eshte shqyrtuar ne KPF dhe me rekomandim te KPF-se ka ardhe per shqyrtim ne kuvend, Anëtarët e KPF-së e kanë shqyrtuar rekomandimin e komisionit dhe kane bere disa vërejtje ne formën e prezentimit te materialit, mirëpo ne fund janë pajtuar qe materialin ta përcjellin per Kuvend.

Shkelzen Hadergjonaaj, kryesues i komisionit- ka sqaruar procedurën e shqyrtimit dhe te miratimit te kërkesave ne komision, ai ka thene se kane qene edhe disa kërkesa tjera mirëpo vetëm dy kërkesa kane kalu dhe kane ardhe këtu per miratim, ndërsa kërkesat tjera per shkak te mangesive nuk i kemi rekomandu ne kuvend per miratim, këto dy propozime i plotësojnë kushtet per emrim te rrugëve.

Shkelqim Haxhnikaj- thot se eshte e vertete çka tha Shkelzeni dhe ne i komision e mbajmë përgjegjësinë per dy propozimet per emrim te rrugëve qe i kemi sjelle sot këtu.

Lirije Zukaj- thot se jam kundër këtyre kërkesave kështu pa meterial sepse kërkesa duhet me na adhe edhe neve.

Florim Mataj- thot se pajtohna me antaret e komisionit dhe arsyetimin qe e bëjnë per emrim te rrugëve , por materiali duhet me na ardhe edhe neve.

Illir Ferizaj- edhe une pajtonha per material, te na vjen komplet materiali mbledhjen tjetër.

Albesa Cacaj-thot se komisioni eshte i formume per shyrtim te kërkesave , ata e kanë krye punen e vet, i kane sjelle rekomandimet dhe e mbajnë përgjegjësinë per rekomandimet qe i bëjnë .

Kryesuesi e qiti ne votim rekomandimin e komisionit per emrim të rrugëve:1.Rruga “Adem H. Zukaj” ne fshatin Beleg, dhe 2.Rruga “Rexhë Pajazitaj” ne fshatin Isniq, antaret e kuvendit e miratuan me shumic votash, rezultati i votimit ishte: 20 per, 1 kunder, 1 abstenim.

VIII.Kerkesa e KF”DEÇANI”.

Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj ka sqaruar se kërkesa ka ardhe per shqyrtim ne KPF mirëpo meqenëse vlera e mjeteve kërkon miratim te kuvendit, KPF e ka percjelle per kuvend per shqyrtim dhe miratim.

Florim Mataj- thot se eshte e nevojshme qe te perkrahet ky klub dhe une jam per..

Albesa Cacaj-thot se kjo menyre e përkrahjes se klubeve sportive nuk eshte ne rregull, drejtoria per kulture duhet ta bene planin per shpërndarje te buxhetit per te gjitha klubet.

Kryesuesi- sqaron se Klubi i futbollit eshte ne gjendje jo te mire dhe sportistët nuk mund te presin plan tani sepse eshte koha e zhvillimit te ndeshjeve sportive, mirëpo eshte bisedu per këto qe u ceken më lartë dhe shpresoj qe ai plan do te behet nga drejtoria per Kulturë.

Mehmet Osaj- thot se këto mjete nuk mjaftojnë per funksionimin e këtij klubi dhe nëse dëshirojmë qe ta mbajmë kete klub propozoj qe te futet me planifikim te buxhetit e jo kështu ne kete menyre.

Kryesuesi- thot se kërkesa eshte vetëm me mbijetu klubi.

Illir Ferizaj- thot se e mbështes kete kerkese dhe mendoj qe te shihet destiancioni i sakte ku do te shkojnë këto mjete dhe pastaj me na ardhe edhe raporti si jan shpenzu.

Kryesuesi- thot se këto janë paraqite ne kerkese dhe janë te domosdoshme per funksionim te klubit.

Mustafë Selmanaj- thot se kjo shume eshte simbolike per funksionim te klubit dhe pa kete mbështetje as nuk mund te funksionon klubi.

Mon Selmonaj- thot se nuk isha ndale vetëm te kjo kerkese por ka edhe kërkesa tjera te ngjashme, ne vazhdim e akuzon pozitën qe nuk po punojnë sa duhet me shprehjen”ju këtu jini kot”..

Erdogan Dautaj- reason ne fjalën e Monit drejtuar pozitës.

Florim Mataj- thot se nëse nuk kërkon falje Moni per akuzën qe pozita nuk po punon, une ne shenje mospajtimi do ta lëshoj sallën.

Ne vazhdim kane reaguar edhe antaret tjerë te pozitës ne shenje mospajtimi me fjalën e Monit.

Mon Selmonaj- thot, sugjeroj qe te ftohen përfaqësuesit e klubeve sportive qe janë aktive ne Deçan, te debatojnë bashke me drejtoreshën e Kultures dhe drejtorin e buxhetit dhe te planifikohen ne buxhet per te gjitha klubet se paku 30.000 €, poashtu klubet duhet te gjejnë edhe forma tjera përmes sponzorëve.

Floim Mataj- i drejtohet Monit, thot une po te propozoj ty Mon antar te kryesise se klubit Deçani dhe e vërteton vet sa mjete shpenzohen per funksionim te Klubit , ndërsa per fjalën qe na the ne pozitë“ju këtu jini kot” nuk pajtohem.

Mon Selmonaj- thot se une ashtu u shpreha vetëm per sport, pa qëllim të keq, por pavarësisht si ka tengellu kjo, po e terhjeki fjalën time.

Drejtori i buxhetit- sqaron se kërkesa eshte vetëm per funksionim te klubit ne sezonin pranveror, pastaj ka kerkuar qe te perkrahet sepse eshte e domosdoshne.

Kryesuesi e qiti ne votim, antaret e kuvendit njëzëri e miratojnë kërkesën e KF”Deçani” ne vlere prej 7000 €.

IX. Shpallja e pronave me interes për nevojat e zgjerimit te rrugës në Qendër të qytetit, pjesë nga parcela nr.00933 shpallet me interes sferfaqja prej 212 m² dhe nga parcela nr.00931-2 shpallet me interes siperfaqja prej 16 m², bazuar në elaboratin gjeodezik.

Kryesuesi- e prezentoj piken pastaj per sqarime fjalën ia ka dhene drejtorit te Urbanizmit, Ramë Melaj- i cili sqaron per nevojën dhe rëndësinë e miratimit te kësaj pike.

Mehme Osaj- ka kerku sqarim nga drejtori pse nuk eshte bere përfundimi i punimeve te nje rruge ne qytetin e Deçanit, per te cilen eshte sqaruar nga drejtori.

Kryesuesi e qiti ne votim, antaret e kuvendit njëzëri miratojnë propozimin e kryetarit te Komunes per shpalljen pronave me interes për nevojat e zgjerimit te rrugës në Qendër të qytetit, pjesë nga parcela nr.00933 shpallet me interes sferfaqja prej 212 m² dhe nga parcela nr.00931-2 shpallet me interes siperfaqja prej 16 m², bazuar në elaboratin gjeodezik.

X. Rishpallja e pronave me interes, per nevojat e rregullimit te shtratit te lumit –Lumbardh i Deçanit, vendim i kuvendit i dt.30.11.2020, i cili kërkon edhe nje here votim ne kuvend dhe marrje te vendimit, për arsye që tri prona atëherë ishin në hipotekë ndërsa tani janë larguar nga hipoteka.

XI.Plani Lokal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për periudhën 2021-2025

XII.Plani për Deponinë e Mbeturinave Inerte për Komunën e Deçanit.

XIII.Plani për Qendrën e Grumbullimit dhe Magazinimit të Mbeturinave të Vëllimshme.

Me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit dhe kërkesën e MAPL, kërkohet që këto tri akte të harmonizohen me dispozitat ligjore në fuqi, prandaj si të tilla edhe një herë duhet ti nënshtrohen procesit të votimit në Kuvend (këto tri pika janë miratuar ne kuvend me dt.28.12.2020). Kryesuesi ka propozuar qe pika X- Rishpallja e pronave me interes, per nevojat e rregullimit te shtratit te lumit –Lumbardh i Deçanit, vendim i kuvendit i dt.30.11.2020, pika nr. XI- Plani Lokal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për periudhën 2021-2025, pika nr. XII- Plani për Deponinë e Mbeturinave Inerte për Komunën e Deçanit.

, dhe pika nr. XIII- Plani për Qendrën e Grumbullimit dhe Magazinimit të Mbeturinave të Vëllimshme, te debatohen dhe votohen si pakete meqenëse kane marre ma herët miratimin e Kuvendit, vetëm kërkohet qe te votohen edhe nje here qe te harmonizohen me ligjin ne fuqi, meqenëse nuk kishte debat ai i i ka qitë në votim katër pikat që kërkohet të marrin edhe një herë miratimin në Kuvend, antarët e kuvendit i miratojnë katër pikat pa debat.Miratimi bëhet njëzëri.

XIV.Të ndryshme.

Mehmet Osaj- thot se Ekzekutivi ka pase me na raportu per per 5 Llotet-prona te dhëna ne shfrytëzim afatgjate, meqenëse nuk eshte bere sot kerkoj qe kjo te behet mbledhjen tjetër.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.


Procesmbajtëse:

Dyke Lolluni



Verifikon procesverbalin:

Kryesuesi i Kuvendit:
Haki Shehaj





Asambleja
01.Nr.III(e jashtëzakonshme)
Deçan,dt.08.04.2021

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e III-të me radhë të Kuvendit në vitin 2021, mbledhje e parë jashtëzakonshme e Asamblesë Komunale ne kete vit, e mbajtur me dt.08.04.2021.

Në mbledhje ishin prezent:19 anëtarë të asamblesë, Kryetari i Komunës, 7 drejtor të drejtorive komunale, OJQ, mediat.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, zotëri Haki Shehaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky rend pune:

1.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale KEDS-it për vendosjen e Stabilimentit shpërndarës në fshatin Irzniq, për degëzimin e rrjetit elektrik për fshatratë Ratishë, Gllogjan, Shaptej etj..

Kryesuesi- e hapi mbledhjen e jashtëzakonshme të kuvendit me përshëndetje per te pranishmit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se janë 19 prezent, e prezentoj piken e vetme te renit te punës e cila u miratua ne kuvend, pastaj per sqarime fjalën ia kalon kryetarit.

Kryetari i Komunes, zotëri, Bashkim Ramosaj, ka sqaruar hollësisht per arsyen e thirrjes se kësaj mbledhje te jashtëzakonshme dhe per nevojën e marrjes se vendimit i cili shkon ne te mire te qytetarve të 16 fshatrave, qe janë ne gjendje shum te keqe me rrjet elektrik dhe furnizim me rryme, ai ka thene se eshte nje investim i KEDS-it ne rrjetin elektrik te 16 fshatrave qe ju nevoitet edhe vendosja e Stabilimentit shpërndarës dhe nëse ne sot nuk e marrim kete vendim ata e qojnë investimin diku tjetër, prandaj ka thene kryetari ju ftoj qe sot ta votoni kete kerkese.

Albesa Cacaj- fillimisht thot kam vërejtje ne afatin e ardhjes se ftesës sepse ligji thot 3 dit, pastaj pse nuk kemi sot këtu përfaqësues te KEDS-i me na dhanë sqarime, dhe shtroj pyetjen sa investime kanë bere KEDS-i ne vitin 2020.

Kryetari- thot se per shkak te urgjencës se çështjes pas konsultimeve qe kemi pase kemi vendose ta bëjmë ftesën dhe administrata e kuvendit me ju sqaru pak me arsyen qe na ka shty qe ta ftojme mbledhjen, sa i përket pjesëmarrjes se përfaqësuesve te KEDS-it ata ia kane letrat me te cilat punojmë si dy pale dhe une nuk mund te ju them qe te vijmë këtu, ne vitin 2020 KEDS-i ka investu ne Komunen e Deçanit ne shumë projekte dhe tash prap duhet ta vazhdojmë bashkëpunimin me ta, dhe e përsëris prap se eshte tepër me rendesi qe te miratohet, dhe behet fjale per 21 m² tokë për vendosje të Stabilimentit shpërndarës.

Valdet Nuraj- thot se nëse ka nevojë per projekte te ngjashme me KEDS-in une jam i gatshëm çdo jave te vi ne mbledhje per hire te asaj pjese te popullsisë sepse kane shum nevoj per rryme dhe i luti edhe kolegt e mi qe ta votojnë këtë kërkesë shum të qëlluar.

Shkelqesa Hadergjonaj- thot se pajtohet me kolegen qe pat vërejtje se nuk eshte respektu ligji dhe statuti kur eshte thirre kjo mbledhje, ndërsa drejtoreshës se re i uorn pune te mbare.

Florim Mataj- thot se e përkrahi kërkesën dhe kerkoj sqarim se a ka KEDS ndonjë afat kohor kure do te realizohen këto projekte, konkret per fshatin Baballoq.

Kryetari-e prezenton drejtoreshën e re te Drejtoris per Ekonomi dhe Zhvillim, e cila e zëvendëson Fitore Shala e cila eshte angazhuar ne pune tjera, pastaj sqaron per fshatin Baballoq qe ka hy ne projekt per shkak te gjendjes se keqe qe e ka me rryme, dhe kam zotim ka thene kryetari qe kah mesi

fshatrat tjera.

Shkelqesa Hadergjonaj- pyet, a e kan verifiku ekspertet rrezikshmërinë nga rryma aty.

Kryetari thot se trafot e reja janë moderne e nuk jan te rrezikshme.

Erdogan Dautaj- thot se e përkrahi kryetarin per këto angazhime ne projekte qe shkojnë ne te mire te qytetarit, si grup parlamentar e përkrahim sepse kërkesa eshte shum e arsyeshme, vetëm kërkon te qitet ne votim.

Ismet Çekaj-thot meqenëse vi nga fshati Irzniq çdo investim aty e mirëpres, pastaj shtron pyetjen sa eshte large nga trotuari, a ka ndonjë efekt anësor dhe pse vendosët qe trafo te vendoset bash ne ate vend.

Kryetari-thot se eshte larg 5m nga trotuari.

Ismet Çekaj- thot se eshte shum afër me trotuarin, une jam pro kësaj kërkesë qe te vendoset trafo ne Irzniq por jo bash ne qat vend, jam per ate qe te vendoset ne nje vend ma te pershtatshem.

Valdet Nuraj-thot se edhe ne fshatin Strelle trafo eshte e kapur me oborr te shkollës dhe nuk paraqet asnjë rrezik, sepse aty e kan parapa ekspertët .

Ismet Çekaj- thot se nëse e vendosim ne oborr te shkollës në Irzniq eshte ma mire , sepse edhe shkolla ka mjaft hapsire, kurse aty eshte afër varrezave dhe nje shtëpie.

Kryetari- thot se nuk kemi mujte mi terhjeke prej aty sepse aty e kan parapa ekspertat mi vendose.

Kryesuesi- e qiti ne votim , meqenëse nuk kishte diskutime tjera, antarët e kuvendit e miratuan me shumic votash, rezultati i votimit 16 per, 2 kunder, 1 abstenim.

Me kete vendim Kuvendi vendosi për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për rastet e veçanta pa kompenzim material, përveq Tatimit në pronë, Kompanisë KEDS-sh.a, Divizioni i Shpërndarjes, për vendosjen e Stabilimentit shpërndarës për furnizim me energji elektrike për fshatrat Irzniq, dy Ratishet, Gillogjan, Shaptej, etj, në parcelën nr.00619-0, nga certifikata: P-70505068-00619-0, stabilimenti ka përmasat (7x3)m, sipërfaqja e dhënë është $S=21m^2$, pronë shoqërore-Komuna e Deçanit, Zona Kadastrale Irzniq.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.


Procesmbajtëse:

Dyke Llolluni



Verifikon procesverbalin:

Kryesuesi i Kuvendit
Haki Shehaj





Asambleja
01.Nr.IV(e jashtëzakonshme)
Deçan,dt.12.04.2021

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e IV-të me radhë të Kuvendit në vitin 2021, mbledhje e dytë jashtëzakonshme e Asamblesë Komunale ne kete vit, e mbajtur me dt.12.04.2021.

Në mbledhje ishin prezent:25 anëtarë të asamblesë, 7 drejtor të drejtorive komunale, OJQ, mediat.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, zotëri Haki Shehaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky rend pune:

-1. Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së projekteve kapitale të vitit 2021 nga fondi rezervë.

Kryesuesi- e hapi mbledhjen e jashtëzakonshme të kuvendit me përshëndetje per te pranishmit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatve dhe konstatoj se janë 25 prezent (mungojnë Shkelzen Hadergjonaj dhe Fatjeta Ramaj), e prezentoj piken e vetme te renit te punës e cila u miratua ne kuvend, pastaj per sqarime fjalën ia kalon drejtorit te buxhetit.

Drejtori i buxhetit, z.Agron Demukaj- sqaron se Ministria e Financave kan kerku qe te miratohet kjo liste e projekteve kapitale, e cila eshte miratuar me buxhet ne muajin shtator.

Ilir Ferizaj- fillimisht thot kam vërejtje ne thirrjen e mbledhjes ne afat më të shkurte se sa e cakton ligji, pastaj pyet, pse disa projekte ne liste janë te hijezume-çka tregon ajo dhe a përfshihet këtu edhe rruga Qendra e qytetit qe po ndërtohet tash dhe nëse eshte cila eshte ne liste.

Milazim Mushkolaj- masi jan nda 100.000 € per bujqësi kure do te fillon ndarja e atyre mjeteve sepse tash eshte koha e mblelljeve.

Mon Selmonaj- perveq vërejtjeve qe u than per ftesë te mbledhjes kam edhe nje kerkese qe mos te dëmtohen asamblistët ne paga siq ka ndodhe ne muajin shkurt, pastaj rreth pikës se rendit te ditës, pyet se a jan këto projekte qe jan miratu me buxhet dhe a ka mundësi te ndryshohet kjo liste, si psh per ndërtim te objektit te ri te komunës kam qene kundër atëherë dhe jam kundër edhe tash.

Albesa Cacaj- pyet se a ka pase mundësi te ndryshohet kjo liste dhe mjetet financiare ti orientojmë per diqka tjetër si psh, per bujqësi, per covid, per raste socilae .

Erdogan Dautaj- sa i përket vërejtjeve per afat te thirrjes se mbledhjes se jashtezakonshme mendoj se nuk paraqet ndonjë problem, sepse edhe ne kuvendin e kosoves po thirret mbledhja brenda dite, si dhe kerkoj qe te na kompenzohet mëditja e muajit shkurt sepse na nuk kemi mbajtje mbledhje sepse nuk na ka thirre askush dhe mëditja na eshte hjeke pa te drejte.

Florim Mataj- thot se per mbledhjen e kaluar te jashtëzakonshme ka qene pak pa afat kurse kjo eshte me afat, pastaj e ngriti qeshtjen e rregullimit të rrugës në fshatin Baballoq dhe problemi kryesor ka thene eshte ne rrugën kryesore.

Kryesuesi- thot se kjo eshte mbledhje e jashtezakoshme dhe duhet te shyrtohet vetëm pika per te cilën eshte thirre dhe nuk mund te ndryshohet asgja, te tjerat ne mbledhje te rregullt.

Ilir Ferizaj- pyet per 100.000 € per objektin e Higjienes dhe kërkon sqarim rreth kësaj sepse po qojmë shum mjete atje ka thene ai.

Albesa Cacaj- pyetje, te restaurimi i kullave, pse nuk i cekni se cilat kulla do te restaurohen sepse kurrë nuk pi dijme se cilat janë ato, pse nuk pi boni ni plan per mirëmbajtje te varrezave –sepse kurr nuk po përfundojnë ato, pastaj kërkon sqarim per projektet -Hartimi i projekteve, Mirembajtje, dhe Asfaltimi i rrugëve ne qytet

Kushtrim Loshaj- pyet, se a ka mundësi komuna qe ti ndanë do mjete per Jetimat e Ballkanit sepse janë 50 kerkesa per shpi nga njerëzit nevojtari.

mi siguru pak.

Agnesa Vokshi- thot se kini premtu bursa për studentë, kerkoj sqarim a do te ndahen bursat per student dhe nëse nuk ka buxhet a ka mundësi mi shu ni projekt dhe me i nda bursat per student.

Shkelqim Haxhnikaj-pyet, sa prej këtyre projekteve do te realizohen deri ne qershor kur do te behet Rishkimi i buxhetit , sepse dyshoj ne realizimin e tyre..

Mehmet Osaj-kerkon te perkrahet bujqësia duke ja shtuar edhe pak shumes se planifikuar me buxhet prej 100.000 €, sepse ndërmarrja Higjiena eshte mire dhe nuk mendoj me i qu atje por ne bujqësi sepse ka ma shum nevoj dhe eshte ma e qëlluar.

Kryesuesi- perserite se është mbledhje e jashtëzakonshme dhe nuk kemi te drejte te dalim nga tema.

Drejtori i buxhetit- pergjigjet ne pyetjet e shtruara: per Ilirin, te hijezimet janë me ngjyrë të verdhë dhe fotokopja i ka qitë te mbyllta, rruga ne qendër, jo, nuk është ne kete liste sepse Ministria e Infrastrukturës e ndanë buxhetin për realizimin e këtij projekti, te objekti i Higjienes janë obligime të ndërtimit të ndërtesës, per Milazimin - -per bujqësi i kemi 100.000 € dhe besoj se do te realizohen, Te Moni-nuk mund te ndryshohen tash projektet vetëm konfirmohen, kurse me rishikim te buxhetit mund te ndryshohen, Te Shkelqimi-ne pyetjen se a do te realizohen- ne do te kryejmë punën tone dhe mbetet per me u pa, Te Albesa-per buxhetin per Covid 19- do ta ndajmë me rishikim te buxhetit, Per Dugin-nese inkasojmë shteti nuk na i hjekin, per Kushtrimin –buxhet per jetimat e Ballkanit do te shohim mundësitë me rishikim te buxhetit se tash nuk kemi, per bursa –prej 20 prillit janë te gatshme dhe ne mbledhjen e rregullt e formojmë komisionin.

Ilir Ferizaj- thot se une mora përgjigje te pjesshme te objekti i Higjienes .

Drejtori Buxhetit- pergjigjet se per kete qeshtje ne e kemi Memorandumin me Ministri dhe dhe si projekt aty e ka emrin ashtu, per Mehmetin- sqaron per harte zonale, ndërsa per memorialë thot se ne e kemi nje kontrate e cila po realizohet per çdo vit, e kini te publikuar edhe ne ueb faqe.

Florim Mataj- pyet lishur me hartimin e Planit Zhvillimor Komunal duke kërkuar se ku jemi me procedura te hartimit te tij dhe prezentimin e tij ne kuvend(sqarimin mbledhjen e radhës)

Mon Selmonaj- thot se per te gjitha këto projekte qe janë ne kete liste eshte dashtë qe te na epni sqarim sepse sqarimet nuk janë bash te kënaqshme tha ai, per këto projekte kemi debatuar edhe kur eshte miratu buxheti 2021 dhe me këto letra qe na i kini sjelle nuk po na bindë me i votu.

Erdogan Dautaj-kerkon qe ta qesim ne votim dhe te miratohet sepse kjo liste eshte miratuar nje here me buxhetin e vitit 2021.

Drejtori i Administrates, Jashar Dobraj sqaron se si thirret mbledhja e jashtëzakonshme ne te cilën nuk ka te drejte te ndryshohet rendi i ditës apo te debatohet per diqka tjetër, ndërsa pyetjet parlamentare behen ne mbledhje te rregullt, jo te jashtëzakonshmen, dhe çdo projekt ne kete liste sot vetëm mund te konfirmohet ndërsa mund te ndryshohet vetëm me rishikim te buxhetit.

Florim Mataj- kërkon sqarim per dy projekte ne fshatin Baballoq: ndërtimi i rrugës dhe Kulla e cila po shkatërrohet çdo ditë.

Drejtori i shërbimeve publike, Izet Zenuni- sqaron se rruga ne Baballoq do te fillon shum shpejte.

Drejtoresha e Kultures, Leonora Ukëhajdaraj- sqaron per Kullen ne fshatin Baballoq, ajo thot se si drejtori e kemi listën e krejte Kullave qe kërkohet te restaurohen, e kemi nje Memorandum me Organizaten VBCH-së, tash e kemi fillu nje Kulle ne fshatin Carrabreg pastaj do te vazhdojmë me tjerat aq sa mundemi.

Florim Mataj- thot se kërkesa ime eshte vetëm mi vizitua Kullën në Baballoq dhe brenda mundësive mi siguru pak qe mos te dëmtohet ma shum.

Kryesuesi- e qiti ne votim propozimin e Ekzekutivit të Listës së projekteve kapitale të vitit 2021 nga fondi rezervë, antaret e kuvendit e miratojnë me shumic votash, rezultati i votimit ishte 18 për, dhe 6 kundër.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse: Dyke Llluni



Verifikon procesverbalin: Kryesuesi i Kuvendit, Haki Shehaj

